



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:045553

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06223995

Ac.nr.1908/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ylber Shudhiqi - kryetar i kolegjit, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit R. H., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A. M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – F. i M., Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.Th., për kompensim e pagave për shpërblim jubilar, pagave përcjellëse për dalje në pension dhe për ushqim gjatë punës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1365/2020, të datës 23.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – F. i M., Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1365/2020, i datës 23.09.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.1365/2020, të datës 23.09.2021, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. H., nga Prishtina. II. DETYROHET e paditura Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – F. i M., Prishtinë, që paditësit, në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite të përvojës së punës t’ia paguaj 150% të vlerës së një page bazë në shumë prej 1,925.01 euro, në emër të tri pagave përcjellëse për dalje në pension t’ia paguaj shumën prej 5,036.28 euro, dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës për 468 ditë pune, për periudhën kohore nga data 18.04.2017, deri me datë 13.05.2019, t’ia paguaj shumën prej 936.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë datë 22.04.2020, e deri në pagesën definitive, si dhe t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 804.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale,

me propozimin që Gjykata e Apeli ta aprovoj ankesën e paraqitur si të bazuar, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 22.04.2020, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar që të aprovohet në tersi kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet e paditura që në emër të shpërblimit jubilar për 40 vite të përvojës së punës t'ia paguaj 150% të vlerës së një page bazë në shumë prej 1,925.01 euro, në emër të tri pagave përcjellëse për dalje në pension t'ia paguaj shumë prej 5,036.28 euro, dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë ditëve të punës për 468 ditë pune, për periudhën kohore nga data 18.04.2017, deri me datë 13.05.2019, t'ia paguaj shumë prej 936.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit.

Pala e paditur në seancën e shqyrtimit përgatitor e ka kontestuar në tersi kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë dhe kërkon nga gjykata të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1365/2020, të datës 23.09.2021, me të cilin ka vendosur më saktësisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si profesor i asocuar në F.e M., dhe së i njëjti ka dalë në pension me datë 13.05.2019, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit prej 65 viteve. Ka shtuar se në bazë të provat e administruara, gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar, ngase është vërtetuar fakti së paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe deri ditën kur është pensionuar ka pasur 40 vite, 5 muaj, e 14 ditë përvojë pune, dhe të njëjtit nuk i është paguar nga e paditura shpërblimi jubilar për 40 vite përvojë pune në vlerën e 150% të një page bazë, si dhe pagesën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit, edhe pse një obligim i tillë është paraparë me nenin 35 par. 8, nënpar. 8.1, 8.5, 8.6, dhe par. 9, nënpar. 9.1, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit datë 18.04.2017.

Sipas dispozitave të sipërcituara i punësuar ka të drejtë në shpërblim jubilar, varësisht nga përvoja e punës, ku për 40 vite përvojë pune, të njëjtit i takon shpërblimi jubilar në vlerë e 150% të një page bazë, dhe së këtë shpërblim ka për obligim që ta paguaj punëdhënësi i fundit, kur i

punësuar i plotëson kushtet sipas kriterëve përkatëse. Ndërsa me rastin e daljes në pension të punësuarit përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, dhe pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit jo me larg se 30 ditë nga dita e pensionimit. Në rastin konkret është vërtetuar së paditësi ka me tepër së 40 vite përvojë pune, andaj gjykata vlerëson se i njëjti i ka plotësuar kushtet e parapara për pagesën e shpërblimit jubilarë në vlerën e 150% të një page bazë, si dhe pagesën përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit, dhe meqenëse e paditura ka qenë punëdhënësi i fundit e njëjta ka për obligim që ta bëjë një pagesë të tillë.

Lidhur me kompensimin në emër të ushqimit gjykata gjeti së e paditura nuk ia ka paguar paditësit kompensimin në emër të ushqimit, për ditët e kaluara në punë, në kohën sa është në fuqi KKAK. Nga vërtetimi i gjendjes faktike lidhur me këtë pjesë të kërkesëpadisë, është vërtetuar se paditësi ka në total 468 ditë prezentë në punë, prandaj gjykata ditët e kaluara në punë të paditësit i ka shumëzuar me 2 €, rrjedhimisht duke i njohur paditësit shumën prej 936.00 €. Këtë llojë kompensimi gjykata ia ka njohur paditësit duke u bazuar në nenin 35 par. 7 të KKAK-së ku është paraparë së *“të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqime gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2(dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore”*.

Gjykata duke ju referuar KKAK-së, të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës dispozitat e së cilës aplikohen në tërë territorin e Kosovës, ku në nenin 35 është paraparë e drejta e punëtorëve të arsimit në shpërblim jubilar dhe kompensim në emër të ushqimit, gjeti se e njëjta është e aplikueshme nga hyrja në fuqi nga data 18.04.2017.

Gjykata me rastin e vendosjes për lartësinë e pagesës në emër të shpërblimit jubilar ka marrë për bazë pagën bazë të cilën e ka realizuar paditësi sipas kontratës së punës e që është në shumë prej 1,283.34 euro, dhe 150% e kësaj page aq sa i takon paditësit për 40 vite të përvojes së punës arrinë shumën prej 1,925.01 euro. Ndërsa për pagat përcjellëse për dalje në pension gjykata ka marrë për bazë pagat që ka realizuar paditësi në tre muajt e fundit para pensionimit, ku në bazë të pasqyrës së llogarisë bankare të lëshuar nga NLB Banka datë 31.05.2021, rezulton së paditësi për muajin shkurt 2019, ka pranuar pagë nga e paditura në shumë prej 1,678.76 euro, për muajin mars 2019, ka pranuar pagën në shumë prej 1,678.76 euro, dhe muajin prill 2019, ka pranuar pagën në shumë prej 1,678.76 euro, dhe në këtë rast vlera e tri pagave të fundit para pensionimit aq sa i takon paditësit arrin shumën prej 5,036.28 euro. Vendimin lidhur me kamatën e ka bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës s e ka bazuar në nenin 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (më gjerësisht sikurse në arsyetim të aktgjykimit të atakuar).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-

së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat janë pretenduar nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe përvoja e punës, ditët e pranisë në punë të paditësit tek e paditura.

Duke vlerësuar pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale se e paditura nuk ka obligim për pagesën e tri pagave përcjellëse për pension, shpërblimin jubilar dhe as shpenzime të ushqimit. Garantuese e përmbushjes së obligimeve financiare nga kërkesëpadia e paditësit është realisht Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave... “pretendimet se paditësi nuk ka dëshmuar se është anëtar sindikal i SBASHK-ut, Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë këto pretendime ankimore pasi që paditësit kjo e drejtë i buron nga neni 35 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe i njëjti i ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë paraprake për realizimin e kërkesës së tij, mirëpo nuk ka mundur ta realizon, andaj i është drejtuar rrugës gjyqësore dhe gjykata e shkallës së parë me të drejtë ia ka njohur këtë me vendim gjyqësor. Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit që në emër të tri pagave përcjellëse për pension t’ia kompensoj shumën e kërkuar me kërkesëpadi ngase me nenin 35 parag.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është e paraparë se: “punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësinë e tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit”. Nga fakti se nga provat e administruara nga gjykata e shkallës së parë ka rezultuar e provuar se paditësi është pensionuar me datë 13.05.2019 dhe në momentin e pensionimit ka pasur përvojë pune 40 vite, 5 muaj, 14 ditë dhe të njëjtit bazuar në dispozitat e cekura më lartë të kontratës kolektive të arsimit, i takon e drejta për kompensimin e tri pagave përcjellëse për në pension dhe 150 % e një page bazë në emër të shpërblimit jubilar. Ndërsa lartësia e pagave mesatare në tre muajt e fundit është provuar përmes listës së pagave të historisë bankare të datës 31.05.2021, ku është vërtetuar se paditësi ka pranuar pagën prej 1,678.76 € në muaj. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e tri pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimin jubilar konform viteve të përvojës së punës së paditësit. Ndërsa, kërkesëpadia e paditësit lidhur me kompensimin e ushqimit gjen mbështetje në nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit ku theksohet se: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë*

marrëdhënien e punës primare në institucionet e arsimore. Duke pasur parasysh se paditësi ka gjithsej 468 ditë të pranisë në punë dhe atë për përudhen kohore nga datë 18.04.2017, e deri me datë 13.05.2019, shihet qartë se paditësit i takon shpërblimi i vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe se Gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejt dhe në përputhje me Kontratën Kolektive të Arsimit, lidhur me të drejtën e paditësit për kompensimin e ushqimit, për faktin se e paditura ka vepruar në kundërshtim me nenin e sipërcituar, duke mos ia kompensuar paditësit shpenzimet e ushqimit që i takojnë, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se: Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...".

Me nenin 35 paragrafin 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: "Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë 8.1. për 10 vjet të përvojës në vlerë të 50 % të një page bazë, 8.2. për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3. për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë, 8.4. për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150 % të një page bazë, 8.5. Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse, 8.6. Shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadiisë së paditësit, duke vendosur saktësisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, e cila kontratë ka qenë në fuqi me rastin e parashtrimit të kërkesës për kompensimin e pagave përcjellëse shpërblimin jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, sipas përvojës së punës së paditësit, që nënkupton se kjo Kontratë shërben si akt nga i cili buron themelësia e kërkesëpadiisë.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridiko - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e pagave përcjellëse shpërblimin jubilar dhe shpenzimeve për ushqim për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: "Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij".

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3728/2022, me datë 26.09.2024

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari
Ylber Shurdhiqi